

Arbërisht
Sërbisë Pleurore
dt 5/10/2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____2021

Lënda: Depozitim projektligji

Drejtuar:

ZNJ. LINDITA NIKOLLA
KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

E nderuar Znj. Kryetare,

Bazuar në nenin 81 të Kushtetutës dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes Projektligjin PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92, DATË 24.07.2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” I NDRYSHUAR.

DEPUTETI PROPOZUES

AGRON DUKA

PROJEKTLIGJ

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92, DATË 24.07.2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, dhe 83 të Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

VENDOSI:

Në Ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Seksioni 4 i kreut 11 shfuqizohet.

2. Pas shkronjës *c*, pika 1, e nenit 69, shtohet shkronja *d* me këtë formulim:

“d. TVSH-në e përlogaritur mbi vleren përfundimtar të transaksionit për blerjen e produkteve bujqësore, nga personi i tatueshëm tek fermerët me autofaturim.

Për efekt të këtij ligji “vlera përfundimtare e transaksionit” është vlera për produktet bujqësore në transaksionin e blerjes së produkteve nga fermerët, në të cilën përfshihet dhe vlera e TVSH-së”.

TVSH llogaritet duke pjestuar “vleren përfundimtare të transaksionit” me koficientin i cili llogaritet në bazë të formules:

$$K = \frac{100 + \text{Norma e TVSH}}{\text{Norma e TVS}}$$

3. Ky ligj hyn në fuqi në 1 janar 2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla